

LIGJ
Nr.10 259, datë 1.4.2010

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE SHITESË PËR MARRËVESHJEN
E PROJEKTIT TË FINANCIMIT, DATË 6.2.2007, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË E NDËRMARRJES SË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE, POGRADEC DHE BANKËS GJERMANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM (KfW) PËR PROGRAMIN E MBROJTJES MJEDISORE TË LIQENIT TË
OHRIT “KANALIZIMET, POGRADEC II””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare shitesë për marrëveshjen e projektit dhe të financimit, datë 6.2.2007, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e Ndërmarrjes së Ujësjiellës-Kanalizimeve, Pogradec dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) për programin e mbrojtjes mjedisore të liqenit të Ohrit “Kanalizimet, Pogradec II””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6503, datë 12.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE FINANCIARE SHITESË

PËR MARRËVESHJEN E PROJEKTIT DHE FINANCIMIT TË DATËS 6.2.2007 NDËRMJET
KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“MARRËSI”),
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË DHE UJËSJELLËS-KANALIZIME
POGRADEC, AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT
për 300 000 euro
Programi i mbrojtjes mjedisore të liqenit të Ohrit
Ujësjiellës-kanalizime Pogradec II

Në bazë të një shkëmbimi notash që ende nuk është kryer midis Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin financiar (Shkëmbim notash), Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja nëpërmjet kësaj bien dakord për Marrëveshjen e mëposhtme financiare shitesë.

Seksioni 1

Modifikimet e Marrëveshjes së projektit dhe financimit

Dispozitat e mëposhtme të marrëveshjes financiare të datës 6.2.2007, për shumën prej 5 000 000 eurosh do të ndryshojnë si më poshtë:

b)Neni 1.1, fjalia 1

“KfW-ja do t’i japë Marrësit një kontribut financiar që nuk tejkalon 5 800 000 euro dhe Marrësi do të sigurojë kontributin e vet shtesë në shumën 940 000 euro.

c) Neni 1.2 fjalia 1

“Marrësi duhet t’ia transferojë të plotë kontributin financiar dhe kontributin e vet financiar Agjencisë së Zbatimit të Projektit, në përputhje me kushtet e parashtruara në nenin 2.”

d) Neni 3.2

“KfW-ja ka të drejtën e refuzimit të kryerjes së rimbursimeve pas datës 31.12.2011”.

Seksioni 2

Vlefshmëria e pandërprerë e marrëveshjes së financimit dhe marrëveshjes së veçantë

Të gjitha klauzolat e tjera të Marrëveshjes së projektit dhe të financimit të datës 6.2.2007 do të mbeten të pandryshuara. Pavarësisht kostos totale të rritur të projektit në përputhje me këtë Marrëveshje financiare shtesë sipas kluzolës 1.3 dhe aneksit nr.4 të marrëveshjes së veçantë, të gjitha dispozitat e tjera të marrëveshjes së veçantë datë 6.2.2007 do të mbeten të pandryshuara.

Seksioni 3

Hyrja në fuqi dhe përfundimi i kësaj Marrëveshjeje

3.1 Kjo Marrëveshje shtesë financimi nuk do të hyjë në fuqi derisa shkëmbimi i notave, mbi të cilën është mbështetur të ketë përfunduar.

3.2 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje shtesë financimi midis KfW-së dhe Marrësit do të përfundojnë me mbarimin e kohës së duhur për projektin, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main
me datë
KfW

Tiranë
me datë
Ministria e Financave
Pogradec
me datë
UK Pogradec